



# KONKURS

Arti Muzikor - Fest Flaka 2023



## KUSHTET DHE INFORMATAT PËR APLIKANTET QË DUHET TË KONKURROJNË

Festivali mbarëkombëtar i këngës populllore-artistike në frymën e traditës fton që te konkurrojnë interpretuesit e këngës populllore-artistike shqipe. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë interpretuesit e pasionuar, nga të gjitha trevat shqiptare, që kultivojnë këtë zhanër.

Këngët do të interpretohen drejtpërdrejtë nën përcjelljen e orkestrës profesionale të Ansamblit Gjilani.

### Fest Flaka do të mbahet me 30 Janar 2023

Te gjithë interpretuesit konkurrues do t`i nënshtrohen audicionit i cili do te mbahet me **07 Janar 2023**, nga ora **13:00h**, ne lokalet e Ansamblit Gjilani, ndërtesa e Teatrit të qytetit -ish-biblioteka e qytetit. **Afati i aplikimit është deri më 06 Janar 2023.**

Të gjithë konkurruesit duhet të kenë te propozuara se paku **3 këngë**

Aplikimi duhet të bëhet në adresën elektronike:  
**festflaka2023@gmail.com**

Juria profesionale do të vlerësojë interpretuesit të cilët do të garojnë për këto shpërblime:

**Çmimi i parë: 450€**

**Çmimi i dytë: 350€**

**Çmimi i tretë: 250€**





## KONKURS

### XIXAT E FLAKËS 2023

Festivali i këngës për fëmijë "Xixat e Flakes" i cili organizohet në kuadër të Manifestimit kulturor "Flaka e Janarit 2023" hap konkurs për pranimin e këngëve për fëmijë të cilat i dedikohen manifestimi.

#### **Kushtet e aplikimit per festival:**

Këngët duhet të ken përbajtje në raport me Manifestimin e **Flakes së Janarit**

Materialet duhet të dorëzohen të kompletuara

**Titulli i kënges**

Të dhënrat për solistin, teksthkruesin, kompozitorin, orkestruesin

Solistet duhet të dorëzojnë nga **dy fotografi**

Audiomaterjalet (**CD, mp3 apo wave**) mund të dorëzohen në objektin Kopshti i fëmijeve Thes Ari, lagjja Dardania I, Gjilan ose në menyre elektronike **xixatfest@gmail.com**

**Festivali ka karakter garues, kënget vlerësohen nga juria profesionale.**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë **fëmijët** e të gjitha **trojeve shqiptare**

**Konkursi mbetet i hapur deri me 20 Janar 2023,**  
**ndërsa lista e këngëve pjesëmarrëse publikohet me 23 Janar 2023.**





# KONKURS



## Peneli i Flakës – Edicioni 32

Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me shoqatën e arteve pamore, në kuadër të manifestimit mbarëkombëtar kulturor

**“Flaka e Janarit 2023”** shpall konkursin tradicional, peneli i flakës me qëllim të nxitjes dhe avansimit të vlerave pamore të krijuesve nga të gjitha trevat shqiptare kudo që ata jetojnë.

Tema e konkursit është e lirë, pjesëmarrësit mund të konkurojn më së shumti me dy punime dhe ate në: Pikturë, Skulpturë, Grafikë, Fotografi artistike dhe medium tjera. Konkursi është i hapur nga **data 22 dhjetor 2022** deri më **07 janar 2023**. Punimet dorëzohen në Galerinë e Arteve, Drejtorinë për kulturë, rini e sport, cdo ditë pune nga ora **08:00 deri 16:00**. Punimet e arritura pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim.

Shoqata do të bëjë të gjitha përgaditjet në mënyrë profesionale, me grupet punuese, kuratori do ta bëj përzgjedhjen e punimeve për këtë edicion. Po ashtu shoqata e Arteve Pamore do ta përgadis edhe katalogun me punimet e këtij edicioni, do të ndaj edhe këto çmime:

**Çmimi blerësi i galerisë 600€ dhe dy çmime 2 x 300 euro**

**Vërejtje:** Autorët bashkë me punimet duhet të sjellin edhe një biografi të shkurtër fizike për të dhënat e sakta personale. Punimet duhet të jenë teknikisht të përgaditura, jo më të mëdha horizontalisht se 120 cm dhe me shënimë të sakta të autorit.

Ekspozita do të hapet ne Galerinë e Arteve më **17 janar 2023**, pas akademisë solemne dhe do të zgjas deri më **31 janar 2023**.

Punimet duhet të tërhiqen më së largu dhjetë ditë pas mbylljes së ekspozitës, në të kundërtën shoqata dhe as drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nuk mbajnë përgjegjësi.





## KONKURS

### KONKURS ANONIM LETRAR

Komuna e Gjilanit, në kuadër të Manifestimit kombëtar të kulturës **“Flaka e Janarit 2023”**, shpall konkursin tradicional letrar për tregim të shkurtër dhe për poezi, me qëllim të nxitjes dhe avancimit të vlerave letrare të krijuesve nga të gjitha trevat shqiptare dhe kudo ku jetojnë ata që shkruajnë shqip.

Tema e konkursit është e lirë. Konkursi është anonim, i hapur nga **23 dhjetor 2022**, deri më **17 janar 2023** dhe, me shifër. Krijimet letrare në poezi e prozë të shkurtër ( gjithsesi të pabotuara në libra, gazeta e revista, portale, internet si dhe rrjete sociale ) dërgohen në tri kopje, adresën: Komuna e Gjilanit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ( qoftë përmes Postës apo Qendrës për Shërbim Qytetar të KK të Gjilanit ) si dhe në adresën elektronike: **penaeflakes2023@gmail.com**

Rezultatet e konkursin anonim letrar shpallen në Orën e Madhe Letrare “Pena e Flakës 2023”, e cila mbahet më **31 janar 2023, ora 13:00** në Bibliotekën e Qytetit.

Të gjithë të interesuarit që konkurojnë, duhet domosdo t’ju përbahen kritereve të konkursit dhe afatit të konkurimit.

#### Për tregim të shkurtër

Çmimi i parë **250€**  
Çmimi i dytë **200€**  
Çmimi i tretë **150€**

#### Për poezi (deri 50 vargje)

Çmimi i parë **250€**  
Çmimi i dytë **200€**  
Çmimi i tretë **150€**

Krijimet e shpërblyera dhe ato që sugjerohen për botim, pas dëshmmimisë së autorësisë, do të btohen në revistën letrare-kulturore **AGMIA** nr. 38





## KONKURIMI

### PËR LEXIM NË ORËN E MADHE LETRARE,

Me qëllim të rritjes së cilësisë dhe vlerës artistike në Orën e Madhe Letrare të Manifestimit **“Flaka e Janarit”, 2023** e njojur tashmë si **PENA E FLAKËS**, si dhe përzgjedhjes më meritore të poezisë fituese, gjithë krijuesit e interesuar të hapësirave shqiptare dhe tjerët që jetojnë e krijojnë në Mërgatë, ftohen për të konkuruar si dhe, nëse përzgjidhen, për të ardhur e lexuar krijimet e tyre në Gjilan, duke u bërë pjesë e garimit të mëtejshmë për Çmimin kryesor të pjesës letrare të Manifestimit.

Poezia e secilit konkuries, duhet të jetë e papublikuar dhe e pashpërbyer diku tjeter si dhe duhet të shoqërohet me një biografi krijuese të autorit dhe dërgohet në njëren nga këto dy adresa, deri më datën **17 janar 2023, ora 24:00**:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, KK Gjilan apo dhe në adresën elektronike: **penaeflakes2023@gmail.com**

Grupi i Punës i pjesës letrare, përzgjedh **20 krijimet** më të mira të cilat do të lexohen në Orën e Madhe Letrare, “Pena e Flakës”.

Një Juri letrare, TRI nga poezitë më të mira të Orës së madhe letrare do t'i nominojë për Çmimin “Pena e Flakës”.

Fituesi bëhet i ditur në Gala mbrëmjen përmbyllëse të Manifestimit “Flaka e Janarit”, **më 31 janar 2023, ora 17:00**.

Për vendin e mbajtjes, të nominuarit njoftohen me kohë.

Poezisë më të mirë të pjesës letrare “PENA E FLAKËS” i takon edhe plaketa, PENA E FLAKËS, që jepet në **Gala Mbrëmjen** përmbyllëse të Manifestimit, më **31 janar 2023**.

Poezia e shpërbyer si dhe të tjerat që lexohen në Orën e Madhe letrare, publikohen në revistën letrare – kulturore **AGMIA** nr. 38

